ASCAP

ASCAP
Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar

MODUL KURRIKULAR

Kurrikula në Bazë Shkolle në Arsimin e Mesëm të Ulët

TRASHËGIMIA KULTURORE ROME

Koordinatore: Erida Koleci, Ines Todhe

www.ascap.edu.al

2026

MODUL KURRIKULAR
KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT
"TRASHËGIMIA KULTURORE ROME"

1. HYRJE

Ky modul trajton trashëgiminë e pasur kulturore të komunitetit rom, një trashëgimi që përfshin gjuhën, historinë, traditat, muzikën, kostumet, artizanatin dhe mënyrat e jetesës, të cilat janë përcjellë brez pas brezi. Në shekuj, romët kanë udhëtuar dhe janë vendosur në shumë vende të ndryshme, duke ruajtur elemente të forta identitare dhe duke u përshtatur me kulturat që i kanë pritur. Gjuha rome me dialektet e saj, zakonet familjare, zejet, këngët, vallëzimet, legjendat dhe mënyra e të treguarit të historive janë pjesë e pandashme e kulturës së tyre. Kjo trashëgimi është një pasuri e çmuar jo vetëm për komunitetin rom, por për të gjithë shoqërinë, sepse na ndihmon të kuptojmë dhe vlerësojmë diversitetin, historinë dhe kontributet e pakicave kombëtare.

Nëpërmjet këtij moduli, nxënësit do të njihen me elementet kryesore të kulturës rome, duke filluar nga origjina historike e komunitetit, rrugët migratore, vendosja në Ballkan dhe veçanërisht në Shqipëri, deri te roli i gjuhës rome në ruajtjen e identitetit. Do të eksplorohen traditat dhe zakonet, veshjet e veçanta, zejet, mënyrat e festimit të ngjarjeve familjare dhe shoqërore, si dhe muzika dhe këngët popullore rome që shquhen për ritme të gjalla dhe përmes të cilave përcillen historia dhe vlerat e komunitetit. Gjithashtu, nxënësit do të mësojnë për figurat e shquara rome dhe kontributin e tyre në art, sport, shkencë, kulturë dhe shoqëri.

Një pjesë e rëndësishme e modulit do t'i kushtohet gjuhës rome si një pasuri e gjallë e kulturës: do të mësohen fjalë dhe shprehje të thjeshta dhe do të diskutohen disa veçori leksikore dhe gramatikore të kësaj gjuhe. Paralelisht me këtë, nxënësit do të lexojnë rrëfime dhe mite rome, duke identifikuar mënyrat si përcillet historia dhe edukimi te fëmijët në këtë kulturë. Rëndësi e veçantë i jepet ndërgjegjësimit dhe respektimit të diversitetit kulturor, duke diskutuar sfidat me të cilat përballen komunitetet rome dhe duke theksuar rëndësinë e tolerancës, barazisë dhe përfshirjes.

Në kontekstin e shoqërisë shqiptare, moduli synon të ndërtojë ura mirëkuptimi midis nxënësve të etnive të ndryshme. Duke mësuar për trashëgiminë rome, nxënësit zhvillojnë aftësinë për të vlerësuar kulturat e tjera dhe për të krijuar mjedise më gjithëpërfshirëse në komunitetin e tyre shkollor dhe më gjerë. Përmes veprimtarive praktike, ekspozitave, intervistave me anëtarë të komunitetit rom dhe të aktiviteteve krijuese, nxënësit do të ndërveprojnë drejtpërdrejt me kulturën rome dhe do të kontribuojnë në ruajtjen dhe promovimin e saj.

Ky modul shërben si një hap i rëndësishëm drejt njohjes dhe vlerësimit të diversitetit kulturor dhe pasurisë së përbashkët që sjellin komunitetet rome në shoqërinë shqiptare.

2. QËLLIMET DHE RËNDËSIA E MODULIT "TRASHËGIMIA KULTURORE ROME"

Moduli "Trashëgimia kulturore rome" është hartuar në përputhje me ligjin nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili përcakton organizimin dhe funksionimin e sistemit arsimor, si dhe strukturën e kurrikulës në arsimin parauniversitar. Sipas këtij ligji, shkollat e arsimit bazë kanë mundësinë të hartojnë ose të zbatojnë module në kuadër të kurrikulës në bazë shkolle, në përputhje me nevojat, interesat dhe karakteristikat e nxënësve dhe të komunitetit ku ato veprojnë.

Moduli mbështetet gjithashtu në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, e cila vendos në qendër zhvillimin e kompetencave kyç, edukimin për qytetari demokratike, respektimin e të drejtave të njeriut, promovimin e diversitetit kulturor dhe forcimin e identitetit kulturor. Ai mbështetet edhe në planin mësimor të arsimit bazë, i cili parashikon hapësirë për zhvillimin e kurrikulës në bazë shkolle. Në këtë kontekst, moduli "Trashëgimia kulturore rome" kontribuon në zhvillimin e kompetencave kyç, si p.sh., kompetencës qytetare, kompetencës së komunikimit dhe të shprehurit, kompetencës personale, kompetencës digjitale etj.

Moduli pasuron programet lëndore të fushave: "Shkencat shoqërore", "Gjuhët dhe komunikimi" dhe "Artet", duke u përqendruar në njohjen, vlerësimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore rome si pjesë e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë, Ballkanit dhe Evropës. Moduli u përgjigjet synimeve të kurrikulës në bazë shkolle, e cila synon:

- plotësimin e nevojave dhe interesave të nxënësve;
- zhvillimin e kompetencave kyç;
- përforcimin e njohurive dhe të aftësive të fituara në lëndët mësimore.

Rëndësia e këtij moduli në arsimin bazë është e veçantë, pasi ai u jep nxënësve mundësinë të njohin dhe të vlerësojnë një prej komuniteteve që ka qenë pjesë e shoqërisë shqiptare për shekuj me radhë. Njohja e trashëgimisë kulturore rome ndihmon në zhvillimin e respektit për dallimet kulturore, në luftimin e stereotipeve dhe paragjykimeve, si dhe në forcimin e mirëkuptimit, tolerancës dhe bashkëjetesës ndërkulturore. Në të njëjtën kohë, ajo i ndihmon nxënësit të kuptojnë se diversiteti kulturor përbën një pasuri për shoqërinë dhe se ruajtja e trashëgimisë kulturore është përgjegjësi e përbashkët e të gjithë qytetarëve.

Trashëgimia kulturore rome përbën një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore evropiane dhe më gjerë. Ajo është formuar gjatë shekujve përmes përvojave historike, lëvizjeve migratore, kontakteve me kultura të ndryshme dhe ruajtjes së traditave të komunitetit. Kjo trashëgimi përfshin elemente materiale dhe jomateriale, të cilat vazhdojnë të transmetohen nga një brez te tjetri dhe të luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e identitetit kulturor rom.

Trashëgimia kulturore rome përfshin:

- gjuhën rome, si një prej elementeve bazë të identitetit kulturor;
- historinë e komunitetit rom, origjinën, migrimet dhe praninë e tij në Shqipëri dhe në Evropë;
- traditat, zakonet dhe mënyrat e jetesës së komunitetit;
- muzikën, vallëzimin dhe artet performuese rome;
- krijimet folklorike si tregimet, legjendat, proverbat dhe mitet rome;
- festat, ritet familjare dhe traditat e përcjella brez pas brezi;
- zejet, veshjet tradicionale dhe elemente të tjera të kulturës materiale;
- figurat dhe personalitetet rome që kanë kontribuar në jetën kulturore, artistike dhe shoqërore.

Njohja e këtyre elementeve ndikon drejtpërdrejt:

- në zhvillimin e respektit për diversitetin kulturor;
- në forcimin e vetëdijes kulturore dhe qytetare;
- në zhvillimin e aftësive për të kërkuar, analizuar, interpretuar dhe prezantuar informacion;
- në përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet nxënësve;
- në zhvillimin e mendimit kritik ndaj stereotipeve dhe paragjykimeve;
- në formimin e qëndrimeve qytetare të bazuara në barazi, respekt, tolerancë dhe përfshirje.

Qëllimet e këtij moduli janë që nxënësit:

- të njohin historinë, gjuhën dhe elementet kryesore të trashëgimisë kulturore rome;
- të kuptojnë rëndësinë e ruajtjes dhe të promovimit të trashëgimisë kulturore;
- të vlerësojnë kontributin e komunitetit rom në jetën kulturore, artistike dhe shoqërore;
- të zhvillojnë respekt për diversitetin kulturor dhe dialogun ndërkulturor;
- të përdorin burime të ndryshme informacioni për të hulumtuar dhe për të prezantuar elemente të kulturës rome;
- të krijojnë produkte individuale ose në grup që promovojnë trashëgiminë kulturore rome;
- të ndërgjegjësohen për rëndësinë e mbrojtjes dhe transmetimit të trashëgimisë kulturore te brezat e ardhshëm.

Në përfundim të modulit, nxënësit pritet të demonstrojnë njohuri mbi historinë, gjuhën, traditat dhe vlerat e kulturës rome, të shfaqin qëndrime pozitive ndaj diversitetit kulturor dhe të jenë në gjendje të prezantojnë dhe të promovojnë elemente të trashëgimisë kulturore rome përmes formave të ndryshme të komunikimit, krijimtarisë dhe punës në grup.

3. PËRMBAJTJA E MODULIT

Ky modul përqendrohet në njohjen, vlerësimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore rome si pjesë e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë dhe të Evropës. Përmes tematikave të ndryshme, nxënësit njihen me historinë, gjuhën, traditat, zakonet, folklorin, muzikën, artin dhe mënyrën e jetesës së komunitetit rom, duke kuptuar rëndësinë e tyre në ruajtjen e identitetit kulturor dhe në pasurimin e diversitetit kulturor të shoqërisë.

Fillimisht, nxënësit njihen me historinë e komunitetit rom, origjinën e tij, lëvizjet migratore ndër shekuj dhe praninë e romëve në Shqipëri dhe në Evropë. Nëpërmjet materialeve të ndryshme, diskutimeve dhe aktiviteteve hulumtuese, ata krijojnë një kuptim më të plotë për zhvillimin historik të komunitetit rom dhe për kontributin e tij në jetën shoqërore dhe kulturore.

Në vijim, vëmendja përqendrohet te gjuha rome, si një prej elementeve bazë të identitetit kulturor rom. Nxënësit njihen me historinë e gjuhës, me veçoritë e saj kryesore, me fjalë dhe shprehje të përdorimit të përditshëm, si dhe me rolin që luan gjuha në ruajtjen dhe transmetimin e kulturës nga një brez te tjetri.

Moduli trajton gjithashtu traditat, zakonet dhe mënyrën e jetesës së komunitetit rom. Nxënësit njihen me festat, ritet familjare, ceremonitë tradicionale dhe vlerat që përcillen përmes tyre. Kjo i ndihmon ata të kuptojnë rëndësinë e trashëgimisë jomateriale dhe të rolit që ajo luan në forcimin e identitetit kulturor.

Një vend të rëndësishëm në modul zënë folklori, muzika dhe vallet rome. Nëpërmjet këngëve, tregimeve, legjendave, proverbave dhe krijimeve të tjera popullore, nxënësit njihen me pasurinë e folklorit rom dhe me mënyrën se si ai ka shërbyer për ruajtjen e kujtesës historike dhe të vlerave të komunitetit. Gjithashtu, ata eksplorojnë rolin e muzikës dhe të vallëzimit si elemente dalluese të kulturës rome dhe ndikimin e tyre në kulturën shqiptare dhe evropiane.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i modulit është njohja me zejet, veshjet tradicionale dhe format e tjera të kulturës materiale rome. Nxënësit hulumtojnë simbolikën, funksionet dhe vlerat kulturore të këtyre elementeve, duke kuptuar lidhjen e tyre me historinë dhe mënyrën e jetesës së komunitetit.

Në një qasje bashkëkohore, moduli i nxit nxënësit të përdorin teknologjinë dhe burime të ndryshme informacioni për të hulumtuar, dokumentuar dhe promovuar trashëgiminë kulturore

rome. Ata angazhohen në veprimtari kërkimore, intervista, prezantime, produkte digjitale dhe aktivitete krijuese që i ndihmojnë të zhvillojnë aftësi kërkimore, komunikuese dhe bashkëpunuese.

Në përmbyllje, nxënësit angazhohen në krijimin e një produkti përfundimtar, individual ose në grup, përmes të cilit prezantojnë dhe promovojnë elemente të trashëgimisë kulturore rome. Ky proces shoqërohet me reflektim, diskutim dhe vlerësim të punës së realizuar, duke i ndihmuar ata të ndërgjegjësohen për rëndësinë e ruajtjes, vlerësimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore rome si pjesë e identitetit dhe e pasurisë së përbashkët kulturore.

Ky modul organizohet në disa tematika, të cilat janë:

- Historia e romëve
- Gjuha rome
- Traditat, zakonet dhe mënyra e jetesës
- Krijimtaria folklorike rome
- Muzika, vallëzimi dhe artet e tjera rome
- Zejet dhe veshjet tradicionale rome
- Trashëgimia kulturore rome në botën bashkëkohore dhe promovimi i saj

1. Historia e romëve

Moduli "Trashëgimia kulturore rome" mund të fillohet me njohjen e historisë së romëve. Romët (quajtur edhe romani) janë një popullsi e madhe që mendohet se ka origjinë nga India veriperëndimore. Gjuhëtarët dhe studiuesit kanë vënë re lidhje mes gjuhës rome dhe dialekteve indo-arike, duke treguar se migrimi i parë i romëve ka filluar rreth shekullit X pas erës së re. Përmes një seri migrimesh të gjata drejt lindjes së Mesdheut dhe Ballkanit, romët u shpërndanë nëpër Evropë, ku sot përbëjnë një nga pakicat më të mëdha në kontinent.

Pasi u vendosën në Evropë, romët përballuan shekuj diskriminimi dhe përjashtimi. Në Mesjetë shumë vende i skllavëruan ose i dëbuan; shekulli XVI i pa romët në Transilvani dhe Moldavi në statusin e skllevërve, ndërsa mbretëritë perëndimore shpesh miratuan ligje kundër "ciganëve" që kufizonin lëvizjen e tyre. Këto politika shkuan deri te deportimi dhe flakja e fëmijëve romë nga familjet e tyre. Persekutimi kulmoi gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur regjimi nazist kreu genocid ndaj romëve, duke vrarë qindra mijëra njerëz.

Me gjithë këto sfida, romët kanë ruajtur gjuhën e tyre, zakonet dhe format e veçanta të artit që pasqyrojnë trashëgiminë e tyre indiane dhe ndikimet lokale. Në shekujt XIX - XX, shumë romë u përfshinë në artizanat, tregti ambulante, argëtim dhe shitje kuajsh. Muzika rome, veçanërisht në variantet rome hungareze, maqedonase, rumune e spanjolle (flamenco), u bë pjesë e

rëndësishme e kulturës së vendeve ku jetonin. Në Shqipëri dhe Ballkan romët kontribuan me zanate, me tregimet gojore dhe me kulturën e dasmave e të riteve familjare.

Sot, romët janë një popullsi heterogjene që jeton në pothuajse çdo shtet europian dhe në diasporë, kryesisht në Amerikë. Ata përballen ende me diskriminim, varfëri dhe mungesë arsimimi. Organizatat ndërkombëtare dhe qeveritë po punojnë për përfshirjen sociale dhe kulturore të tyre. Kuptimi i historisë së romëve, prej origjinës indo-arike dhe migrimeve të hershme deri te përvojat e përndjekjes dhe kontributet e tyre kulturore, i ndihmon nxënësit të zhvillojnë respekt për diversitetin dhe të vlerësojnë një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të Shqipërisë dhe të Evropës.

2. Gjuha rome

Gjuha rome (romani) përbën një nga elementet më të rëndësishme të identitetit kulturor të komunitetit rom. Ajo nuk është thjesht një mjet komunikimi, por një bartëse e historisë, kujtesës, traditave dhe vlerave të komunitetit. Përmes saj janë transmetuar brez pas brezi tregime, këngë, proverba, zakone dhe përvoja jetësore, duke luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e identitetit kulturor rom.

Studimet gjuhësore kanë treguar se gjuha rome i përket familjes së gjuhëve indo-evropiane dhe, më konkretisht, degës indo-ariane. Kjo e lidh atë me gjuhë të tilla si hindishtja, punjabia dhe gjuhë të tjera të Indisë Veriore. Pikërisht analiza e gjuhës rome ka qenë një nga provat më të rëndësishme që ka ndihmuar studiuesit të përcaktojnë origjinën indiane të romëve. Shumë fjalë themelore të romanishtes kanë ngjashmëri me fjalët përkatëse në gjuhët indo-ariane, duke ruajtur gjurmë të qarta të prejardhjes së saj.

Gjatë migrimeve shumë shekullore nga India drejt Lindjes së Mesme dhe më pas Evropës, gjuha rome është pasuruar me elemente nga gjuhët me të cilat romët kanë rënë në kontakt. Në fjalorin e saj gjenden huazime nga persishtja, armenishtja, greqishtja, gjuhët sllave, turqishtja, rumanishtja, shqipja dhe gjuhë të tjera evropiane. Këto ndikime përbëjnë dëshmi të rrugës historike të ndjekur nga romët dhe të marrëdhënieve që ata kanë krijuar me popuj të ndryshëm.

Një nga karakteristikat kryesore të gjuhës rome është larmia e dialekteve. Për shkak të shpërndarjes së romëve në vende të ndryshme dhe kontakteve me gjuhë të ndryshme, gjuha rome nuk paraqitet si një formë e vetme e njëtrajtshme, por si një grup dialektesh që kanë elemente të përbashkëta, por edhe dallime të dukshme. Studiuesit zakonisht i klasifikojnë këto dialekte në disa grupe të mëdha, si dialektet vlax, ballkanike, qendrore, veriore dhe iberike. Megjithatë, pavarësisht dallimeve, folësit e dialekteve të ndryshme arrijnë shpesh të kuptojnë njëri-tjetrin, sidomos kur përdorin forma më të thjeshta të komunikimit.

Në Shqipëri fliten kryesisht variante të dialekteve ballkanike dhe vlax të gjuhës rome. Për shkak të bashkëjetesës së gjatë me popullsinë shqiptare, gjuha rome në Shqipëri ka përvetësuar një numër të konsiderueshëm fjalësh nga gjuha shqipe, ndërsa shumë romë janë dygjuhësh ose shumëgjuhësh. Në jetën e përditshme ata përdorin njëkohësisht gjuhën rome dhe gjuhën shqipe, duke kaluar nga njëra gjuhë në tjetrën sipas situatës së komunikimit.

Ashtu si shumë gjuhë të tjera minoritare, edhe gjuha rome është përballur me sfida të ndryshme. Në disa vende numri i folësve është zvogëluar për shkak të urbanizimit, migrimit, asimilimit kulturor dhe përdorimit gjithnjë e më të madh të gjuhëve shumicë. Për këtë arsye, organizata ndërkombëtare, institucione arsimore dhe organizata të komunitetit rom kanë ndërmarrë iniciativa për ruajtjen dhe promovimin e gjuhës rome. Sot ekzistojnë fjalorë, libra, revista, programe radiofonike, faqe interneti dhe materiale mësimore në gjuhën rome, të cilat synojnë të forcojnë përdorimin e saj dhe t'ua transmetojnë brezave të rinj.

Këshilli i Evropës dhe organizata të tjera ndërkombëtare e konsiderojnë gjuhën rome një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore evropiane. Në disa vende ajo mësohet në shkolla, përdoret në media dhe përfshihet në programe kulturore që promovojnë diversitetin gjuhësor dhe kulturor. Ruajtja e gjuhës rome nuk ka rëndësi vetëm për komunitetin rom, por edhe për pasurinë kulturore të Evropës në tërësi, pasi çdo gjuhë përfaqëson një mënyrë të veçantë të të menduarit, të shprehjes dhe të kuptimit të botës.

Për komunitetin rom, gjuha është një element themelor i identitetit. Ajo lidh individin me historinë e paraardhësve, me traditat e komunitetit dhe me përvojat e përbashkëta të brezave. Përmes gjuhës ruhen kujtesa historike, folklori, këngët, urimet, proverbat dhe mënyrat tradicionale të komunikimit. Për këtë arsye, njohja dhe vlerësimi i gjuhës rome përbën një hap të rëndësishëm drejt kuptimit më të plotë të kulturës dhe trashëgimisë rome.

3. Traditat, zakonet dhe mënyra e jetesës

Traditat dhe zakonet përbëjnë një pjesë të rëndësishme të identitetit kulturor rom. Ato janë formuar gjatë shekujve dhe janë transmetuar brez pas brezi, duke ndihmuar në ruajtjen e vlerave, normave dhe mënyrës së jetesës së komunitetit. Edhe pse romët jetojnë në vende të ndryshme dhe janë ndikuar nga kultura të ndryshme, shumë tradita dhe zakone vazhdojnë të ruhen dhe të përcillen si pjesë e trashëgimisë së tyre kulturore.

Në kulturën rome, familja zë një vend qendror. Familja nuk përfshin vetëm prindërit dhe fëmijët, por shpesh edhe gjyshërit, dajat, hallat, tezet dhe të afërm të tjerë, të cilët luajnë rol të rëndësishëm në edukimin dhe mbështetjen e anëtarëve më të rinj. Respekti për më të moshuarit

konsiderohet një vlerë themelore. Ata vlerësohen si bartës të përvojës, kujtesës dhe traditave të komunitetit dhe shpesh kanë rol këshillues në çështjet familjare dhe shoqërore.

Një karakteristikë e rëndësishme e kulturës rome është ndjenja e fortë e solidaritetit dhe ndihmës reciproke. Në shumë komunitete rome, anëtarët e familjes dhe të komunitetit mbështesin njëri-tjetrin në raste gëzimi dhe vështirësie. Bashkëpunimi, mikpritja dhe ndarja e burimeve konsiderohen vlera të rëndësishme që ndihmojnë në forcimin e lidhjeve shoqërore.

Martesa dhe familja kanë një rëndësi të veçantë në jetën e komunitetit rom. Ceremonitë e martesës shoqërohen zakonisht me festime të gjata, muzikë, vallëzim dhe pjesëmarrje të gjerë të familjes dhe komunitetit. Edhe pse format dhe zakonet ndryshojnë nga një komunitet rom në tjetrin dhe nga një vend në tjetrin, martesa vazhdon të konsiderohet një ngjarje me rëndësi të madhe shoqërore dhe familjare.

Festat dhe ceremonitë tradicionale përbëjnë një pjesë të rëndësishme të jetës kulturore rome. Shumë komunitete rome festojnë festa fetare sipas besimit që ndjekin (mysliman, i krishterë ortodoks, katolik ose protestant), ndërsa krahas tyre ruajnë edhe tradita dhe zakone të veçanta komunitare. Në këto raste, muzika, këngët, vallëzimi dhe gatimet tradicionale luajnë rol të rëndësishëm në forcimin e identitetit dhe ndjenjës së përkatësisë.

Historikisht, mënyra e jetesës së romëve ka qenë e lidhur me lëvizjen dhe udhëtimin. Megjithatë, sot shumica e romëve jetojnë në vendbanime të qëndrueshme dhe janë pjesë e jetës ekonomike dhe shoqërore të vendeve ku banojnë. Për këtë arsye, mënyra e jetesës së romëve nuk mund të përshkruhet me një model të vetëm. Ajo ndryshon sipas vendit, kushteve ekonomike, nivelit të arsimimit dhe traditave lokale.

Në jetën e përditshme, romët i kushtojnë rëndësi të veçantë marrëdhënieve shoqërore dhe jetës komunitare. Vizitat familjare, takimet me të afërmit dhe pjesëmarrja në ngjarje të përbashkëta janë pjesë e rëndësishme e kulturës së tyre. Këto marrëdhënie ndihmojnë në ruajtjen e identitetit kulturor dhe në transmetimin e traditave te brezat e rinj.

Traditat dhe zakonet rome nuk kanë mbetur të pandryshuara. Ashtu si çdo kulturë tjetër, edhe kultura rome ka evoluar me kalimin e kohës. Urbanizimi, arsimi, teknologjia, migrimi dhe kontaktet me kultura të tjera kanë sjellë ndryshime në mënyrën e jetesës së shumë familjeve rome. Megjithatë, pavarësisht këtyre ndryshimeve, vlera të tilla si rëndësia e familjes, respekti për të moshuarit, solidariteti, mikpritja dhe ruajtja e traditave vazhdojnë të mbeten elemente të rëndësishme të identitetit kulturor rom.

Njohja e traditave, zakoneve dhe mënyrës së jetesës së komunitetit rom i ndihmon nxënësit të kuptojnë më mirë pasurinë dhe larminë e kulturave që bashkëjetojnë në shoqërinë shqiptare. Ajo kontribuon në zhvillimin e respektit për diversitetin kulturor, në kapërcimin e stereotipeve

dhe në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, më gjithëpërfshirëse dhe më respektuese ndaj dallimeve kulturore.

4. Krijimtaria folklorike rome

Krijimtaria folklorike rome përbën një nga pasuritë më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të komunitetit rom. Për shekuj me radhë, romët kanë ruajtur historinë, përvojat, vlerat dhe botëkuptimin e tyre kryesisht përmes traditës gojore. Për shkak se gjuha rome ka qenë për një kohë të gjatë kryesisht gjuhë e folur dhe jo e shkruar, folklori ka luajtur një rol të veçantë në transmetimin e kulturës nga një brez te tjetri.

Folklori rom përfshin një larmi të madhe krijimesh popullore, si përralla, legjenda, mite, tregime, anekdota, proverba, thënie të urta, gjëegjëza, këngë dhe rrëfime autobiografike. Këto krijime pasqyrojnë historinë e komunitetit, marrëdhëniet familjare, jetën e përditshme, sfidat, shpresat dhe vlerat që kanë karakterizuar jetën e romëve ndër shekuj.

Një vend të rëndësishëm në folklorin rom zënë përrallat popullore. Ashtu si në folklorin e popujve të tjerë, edhe në përrallat rome gjenden personazhe të mençur, heronj, mbretër, zanë, kafshë që flasin dhe figura të tjera fantastike. Megjithatë, shumë prej tyre pasqyrojnë edhe përvojat historike të komunitetit rom, si udhëtimet, kërkimi i lirisë, mbijetesa dhe përballja me vështirësitë. Në këto tregime shpesh triumfojnë zgjuarsia, guximi, drejtësia dhe solidariteti.

Legjendat dhe tregimet popullore rome shpjegojnë origjinën e vendeve, të zakoneve ose të ngjarjeve të ndryshme. Ato shpesh ndërthurin elemente historike me elemente fantastike dhe pasqyrojnë mënyrën se si komuniteti ka interpretuar botën përreth. Në shumë raste, këto rrëfime kanë shërbyer si një mjet për të ruajtur kujtesën historike dhe identitetin kulturor.

Një pjesë e rëndësishme e folklorit rom janë proverbat dhe thëniet e urta. Ato përcjellin përvojën jetësore të brezave dhe përmbajnë mësime morale, këshilla dhe reflektime mbi jetën. Shumë prej tyre lidhen me rëndësinë e familjes, punës, respektit, mençurisë dhe marrëdhënieve njerëzore. Përmes këtyre formave të shkurtra të krijimtarisë gojore, romët kanë transmetuar vlera dhe norma shoqërore nga një brez te tjetri.

Edhe gjëegjëzat kanë qenë pjesë e rëndësishme e traditës folklorike rome. Ato përdoren si formë argëtimi, por edhe si mjet për zhvillimin e mendimit, vëmendjes dhe zgjuarsisë. Në të kaluarën, gjëegjëzat shpesh tregoheshin gjatë mbrëmjeve familjare ose në takimet komunitare.

Një veçori e rëndësishme e folklorit rom është lidhja e tij e ngushtë me jetën e përditshme. Shumë tregime dhe këngë pasqyrojnë marrëdhëniet familjare, dashurinë, miqësinë, udhëtimet, punën dhe përpjekjet për të përballuar vështirësitë. Kjo e bën folklorin rom një burim të vlefshëm për të kuptuar historinë dhe kulturën e komunitetit.

Në kulturën rome, tregimtari tradicional ka pasur një rol të rëndësishëm. Ai nuk ishte thjesht një person që tregonte histori, por një bartës i kujtesës kolektive dhe i traditave të komunitetit. Përmes tregimeve të tij, brezat më të rinj mësonin për historinë, vlerat dhe normat e jetës në komunitet.

Sot, një pjesë e konsiderueshme e folklorit rom është mbledhur, dokumentuar dhe botuar nga studiues, shkrimtarë dhe organizata kulturore. [1]Megjithatë, tradita gojore vazhdon të mbetet një element i rëndësishëm i kulturës rome. Në shumë familje dhe komunitete, tregimet, proverbat dhe rrëfimet vazhdojnë të përcillen në mënyrë gojore, duke ruajtur gjallë kujtesën dhe identitetin kulturor.

Njohja e krijimtarisë folklorike rome i ndihmon nxënësit të kuptojnë pasurinë e kulturës rome dhe rolin që folklori luan në ruajtjen e identitetit kulturor. Ajo gjithashtu u mundëson atyre të zbulojnë ngjashmëri dhe dallime mes folklorit rom dhe folklorit shqiptar, duke zhvilluar respekt për diversitetin kulturor dhe për format e ndryshme të shprehjes artistike që ekzistojnë në shoqërinë tonë.

5. Muzika, vallëzimi dhe artet e tjera rome

Muzika, vallëzimi dhe artet përbëjnë ndër elementet më të njohura dhe më të vlerësuara të trashëgimisë kulturore rome. Në shumë vende të Evropës dhe më gjerë, kultura rome identifikohet shpesh me muzikën e saj të pasur, ritmet karakteristike, interpretimin virtuoz dhe aftësinë për të shprehur emocione të forta përmes artit. Për shekuj me radhë, muzika ka qenë jo vetëm një formë argëtimi, por edhe një mënyrë për të ruajtur kujtesën historike, për të përcjellë traditat dhe për të forcuar identitetin kulturor të komunitetit rom.

Në kulturën rome, muzika shoqëron pothuajse çdo moment të rëndësishëm të jetës: festat familjare, martesat, lindjet, ceremonitë fetare dhe takimet komunitare. Ajo shërben si mjet komunikimi dhe si mënyrë për të shprehur gëzimin, trishtimin, dashurinë, mallin, krenarinë dhe përvojat e jetës së përditshme. Përmes këngëve janë ruajtur ngjarje historike, kujtime kolektive dhe histori personale që kanë kaluar nga një brez te tjetri.

Një nga karakteristikat më të dallueshme të muzikës rome është interpretimi emocional dhe improvizimi. Muzikantët romë njihen për aftësinë e tyre për të krijuar variacione të reja gjatë

[1] Qirici, Mina T. (2004). *Romët e Shqipërisë në folklor: tipare & dallime; studim dhe shtatë përralla të zgjedhura*
Google Books – Roma of Albania in Folklore
WorldCat – Princi Qyqar: përrallë sipas motiveve të folklorit rom

interpretimit, duke i dhënë secilës performancë një karakter unik. Kjo traditë e improvizimit ka ndikuar edhe në zhvillimin e zhanreve të ndryshme muzikore në Evropë.

Në vende të ndryshme, muzika rome ka marrë forma të ndryshme. Në Spanjë, romët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e flamencos, një prej formave më të njohura të muzikës dhe vallëzimit spanjoll. Në Hungari, Rumani, Serbi, Maqedoninë e Veriut dhe vende të tjera të Ballkanit, muzikantët romë kanë ndikuar në zhvillimin e muzikës popullore dhe qytetare. Shumë ansamble tradicionale të njohura në këto vende kanë pasur ose vazhdojnë të kenë muzikantë romë si pjesë të tyre.

Instrumentet muzikore të përdorura nga romët ndryshojnë sipas rajonit ku jetojnë. Ndër instrumentet më të përdorura janë:

- violina;
- klarineta;
- fizarmonika;
- kitara;
- daullja;
- tamburja;
- kontrabasi;
- cimbali (instrument tradicional me tela i përdorur në Evropën Qendrore dhe Lindore).

Përveç muzikës, vallëzimi zë një vend të rëndësishëm në kulturën rome. Vallet rome karakterizohen nga energjia, ritmi i gjallë, lëvizjet ekspresive dhe ndërveprimi me muzikën. Në shumë raste, vallëzimi nuk ndjek një koreografi të ngurtë, por i lejon valltarit të shprehë individualitetin dhe emocionet e tij. Lëvizjet e duarve, ritmi i këmbëve dhe përdorimi i veshjeve shumëngjyrëshe i japin vallëzimit rom një identitet të veçantë artistik.

Krahas muzikës dhe vallëzimit, romët kanë dhënë kontribut edhe në fusha të tjera artistike. Në shumë vende ka piktorë, skulptorë, aktorë, poetë dhe shkrimtarë romë që kanë pasuruar kulturën kombëtare dhe ndërkombëtare. Letërsia rome është zhvilluar veçanërisht gjatë shekullit XX dhe XXI, kur autorë romë kanë filluar të shkruajnë për historinë, identitetin dhe përvojat e komunitetit të tyre.

Teatri rom është një tjetër formë e rëndësishme e shprehjes artistike. Përmes shfaqjeve teatrore trajtohen tema që lidhen me jetën e komunitetit, historinë, traditat, diskriminimin dhe aspiratat për një të ardhme më të mirë. Në disa vende evropiane janë krijuar teatro profesionale rome që promovojnë gjuhën dhe kulturën rome.

Në ditët e sotme, artistët romë janë të pranishëm në skenat kombëtare dhe ndërkombëtare. Muzikantë, këngëtarë, valltarë, aktorë dhe krijues romë kontribuojnë në pasurimin e jetës

kulturore dhe artistike të vendeve ku jetojnë. Festivale, koncerte dhe aktivitete kulturore organizohen çdo vit për të promovuar artin rom dhe për ta bërë atë më të njohur për publikun e gjerë.

Muzika, vallëzimi dhe artet e tjera rome përfaqësojnë një pasuri të rëndësishme kulturore, e cila dëshmon krijimtarinë, qëndrueshmërinë dhe identitetin e komunitetit rom. Njohja e këtyre formave artistike i ndihmon nxënësit të kuptojnë më mirë kulturën rome, të vlerësojnë kontributin e saj në kulturën evropiane dhe të zhvillojnë respekt për diversitetin kulturor dhe artistik.

6. Zejet dhe veshjet tradicionale rome

Zejet dhe veshjet tradicionale përbëjnë një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore rome. Për shumë shekuj, romët janë dalluar për aftësitë e tyre në zanate të ndryshme, të cilat jo vetëm kanë siguruar jetesën e familjeve të tyre, por kanë kontribuar edhe në zhvillimin ekonomik dhe kulturor të shoqërive ku kanë jetuar. Në të njëjtën kohë, veshjet tradicionale rome kanë shërbyer si shprehje e identitetit kulturor, e përkatësisë komunitare dhe e vlerave estetike të komunitetit.

Historikisht, shumë grupe rome janë marrë me zeje që kërkonin aftësi të specializuara dhe që shpesh përcilleshin nga prindërit te fëmijët. Ndër zanatet më të njohura kanë qenë farkëtaria, përpunimi i metaleve, kallajisja, punimi i bakrit, prodhimi dhe riparimi i veglave bujqësore, punimet në dru, përpunimi i lëkurës dhe tregtia ambulante. Në shumë vende të Evropës, romët fituan reputacion si mjeshtër të zotë në përpunimin e metaleve dhe në riparimin e enëve dhe veglave të përdorimit të përditshëm.

Në Ballkan dhe në Shqipëri, romët kanë ushtruar tradicionalisht profesione të ndryshme artizanale, si farkëtarë, kallajxhinj, muzikantë, tregtarë dhe zejtarë të specializuar. Këto profesione luajtën një rol të rëndësishëm në ekonominë lokale, veçanërisht në periudhat kur prodhimi industrial ishte i kufizuar dhe shumë produkte realizoheshin me dorë.

Ashtu si kulturat e tjera, edhe komunitetet rome janë përshtatur me ndryshimet ekonomike dhe shoqërore. Me zhvillimin e industrisë dhe teknologjisë, shumë zeje tradicionale humbën rëndësinë ekonomike që kishin dikur. Megjithatë, në disa komunitete vazhdojnë të ruhen aftësi tradicionale të punimit me dorë, të cilat konsiderohen pjesë e trashëgimisë kulturore dhe identitetit rom.

Një element tjetër i rëndësishëm i kulturës materiale rome janë veshjet tradicionale. Edhe pse nuk ekziston një veshje e vetme tradicionale për të gjithë romët, pasi stilet ndryshojnë sipas

vendeve dhe rajoneve ku ata jetojnë, në shumë komunitete ruhen elemente karakteristike që i dallojnë nga kulturat e tjera.

Veshjet tradicionale të grave rome zakonisht karakterizohen nga:

- funde të gjata dhe të gjera me ngjyra të ndezura;
- bluza dhe jelekë të zbukuruar;
- përdorimi i shamive të kokës në disa komunitete;
    - stoli të shumta, si varëse, byzylykë, unaza dhe vathë;
    - motive dekorative me lule, forma gjeometrike dhe ngjyra të forta.

Ngjyrat e ndezura dhe zbukurimet kanë shpesh funksion estetik, por në disa raste lidhen edhe me traditat dhe identitetin kulturor të grupit përkatës.

Veshjet tradicionale të burrave janë zakonisht më të thjeshta dhe ndikohen më shumë nga kultura e rajonit ku jetojnë. Megjithatë, në raste festash dhe ceremonish mund të përdoren elemente të veçanta tradicionale, si jelekë të qëndisur, rripa dekorativë ose kapele karakteristike.

Stolitë zënë një vend të rëndësishëm në kulturën rome. Ato nuk përdoren vetëm si zbukurime, por shpesh kanë edhe vlerë simbolike dhe familjare. Në shumë familje rome, stolitë kalojnë nga një brez te tjetri dhe konsiderohen pjesë e trashëgimisë familjare.

Sot, veshjet tradicionale rome përdoren kryesisht gjatë festave, dasmave, festivaleve kulturore dhe aktiviteteve që synojnë promovimin e kulturës rome. Në jetën e përditshme, shumica e romëve vishen sipas modës bashkëkohore të vendeve ku jetojnë. Megjithatë, ruajtja dhe promovimi i veshjeve tradicionale vazhdon të ketë rëndësi si mënyrë për të mbajtur gjallë identitetin kulturor dhe lidhjen me traditat e komunitetit.

Zejet dhe veshjet tradicionale rome dëshmojnë aftësitë krijuese, mënyrën e jetesës dhe historinë e komunitetit rom. Ato përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore materiale dhe ndihmojnë në kuptimin e rolit që romët kanë luajtur në jetën ekonomike, shoqërore dhe kulturore të vendeve ku kanë jetuar. Njohja e tyre u mundëson nxënësve të vlerësojnë më mirë pasurinë e kulturës rome dhe rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore në një shoqëri të larmishme dhe gjithëpërfshirëse.

7. Trashëgimia kulturore rome në botën bashkëkohore dhe promovimi i saj

Trashëgimia kulturore rome vazhdon të jetë një pjesë e rëndësishme e mozaikut kulturor evropian dhe botëror. Megjithëse komunitetet rome kanë përjetuar ndryshime të shumta shoqërore, ekonomike dhe kulturore gjatë shekujve, ato kanë arritur të ruajnë një pjesë të konsiderueshme të identitetit të tyre kulturor. Gjuha, muzika, folklori, traditat familjare, zejet

dhe format e ndryshme të krijimtarisë artistike vazhdojnë të jenë elemente që lidhin brezat dhe forcojnë ndjenjën e përkatësisë kulturore.

Në botën bashkëkohore, trashëgimia kulturore rome përballet njëkohësisht me mundësi dhe sfida. Nga njëra anë, globalizimi, urbanizimi, migrimi dhe zhvillimi teknologjik kanë krijuar mundësi të reja për komunikim, shkëmbim kulturor dhe promovim të kulturës rome. Nga ana tjetër, këto procese mund të çojnë edhe në dobësimin e disa traditave, në zvogëlimin e përdorimit të gjuhës rome ose në humbjen e praktikave kulturore që nuk përcillen më te brezat e rinj.

Për këtë arsye, ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore rome janë bërë një prioritet për shumë organizata, institucione dhe komunitete rome në mbarë Evropën. Sot ekzistojnë iniciativa të ndryshme që synojnë dokumentimin, mbrojtjen dhe promovimin e historisë, gjuhës dhe kulturës rome. Këto iniciativa përfshijnë botime, festivale kulturore, ekspozita, muze, arkiva digjitale, programe arsimore dhe projekte artistike që synojnë të bëjnë më të njohur trashëgiminë rome dhe të nxisin respektin për diversitetin kulturor.

Një rol të rëndësishëm në promovimin e kulturës rome luajnë organizatat ndërkombëtare dhe institucionet evropiane. Këshilli i Evropës, Bashkimi Evropian, UNESCO dhe organizata të tjera kanë mbështetur projekte që promovojnë kulturën rome dhe fuqizojnë pjesëmarrjen e komuniteteve rome në jetën kulturore dhe shoqërore. Këto institucione e konsiderojnë kulturën rome pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore evropiane dhe nxisin ruajtjen e saj për brezat e ardhshëm.

Një moment i rëndësishëm për identitetin kulturor rom është 8 Prilli - Dita Ndërkombëtare e Romëve, e cila festohet çdo vit në shumë vende të botës. Kjo ditë shërben për të promovuar historinë, kulturën dhe kontributin e romëve në shoqëri, si dhe për të rritur ndërgjegjësimin për sfidat me të cilat ata vazhdojnë të përballen. Në këtë kuadër organizohen aktivitete kulturore, koncerte, ekspozita, konferenca dhe fushata informuese. Po kështu më 5 Nëntor festohet Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Rome. Kjo ditë synon të promovojë përdorimin, ruajtjen dhe transmetimin e gjuhës rome te brezat e rinj, si një element i rëndësishëm i identitetit kulturor rom.

Teknologjia dhe mediat digjitale kanë krijuar mundësi të reja për promovimin e trashëgimisë kulturore rome. Sot kultura rome prezantohet përmes faqeve të internetit, muzeve virtuale, platformave digjitale, dokumentarëve, podkasteve, filmave dhe rrjeteve sociale. Këto mjete ndihmojnë në dokumentimin dhe shpërndarjen e njohurive për historinë dhe kulturën rome, duke i bërë ato më të aksesueshme për publikun e gjerë.

Një rëndësi të veçantë ka edhe përfshirja e historisë dhe kulturës rome në arsim. Njohja e trashëgimisë kulturore rome në shkolla ndihmon nxënësit të kuptojnë më mirë historinë dhe kulturën e një komuniteti që ka qenë pjesë e shoqërisë shqiptare dhe evropiane për shekuj me radhë. Kjo kontribuon në luftimin e stereotipeve, në promovimin e respektit për dallimet kulturore dhe në ndërtimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse.

Vetë komunitetet rome luajnë një rol vendimtar në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë së tyre kulturore. Familjet, artistët, studiuesit, aktivistët dhe organizatat rome punojnë për të dokumentuar traditat, për të mbrojtur gjuhën rome, për të promovuar artin dhe folklorin rom dhe për të siguruar që kjo trashëgimi të mos humbasë me kalimin e kohës. Në shumë vende janë krijuar qendra kulturore rome, ansamble artistike, festivale dhe programe edukative që synojnë të forcojnë identitetin kulturor dhe të rrisin njohjen e kulturës rome.

Ruajtja e trashëgimisë kulturore rome nuk është vetëm përgjegjësi e komunitetit rom. Ajo është pjesë e përpjekjeve më të gjera për mbrojtjen e diversitetit kulturor dhe të trashëgimisë së përbashkët njerëzore. Njohja, respektimi dhe promovimi i kulturës rome ndihmojnë në ndërtimin e një shoqërie më demokratike, më tolerante dhe më të pasur nga pikëpamja kulturore.

Në botën bashkëkohore, trashëgimia kulturore rome vazhdon të zhvillohet dhe të pasurohet. Ajo nuk përfaqëson vetëm të kaluarën e komunitetit rom, por edhe kontributin e tij në jetën kulturore të së tashmes dhe të së ardhmes. Për këtë arsye, njohja dhe promovimi i saj janë të rëndësishme jo vetëm për romët, por për të gjithë ata që vlerësojnë diversitetin kulturor dhe pasurinë e kulturave që bashkëjetojnë në shoqërinë moderne.

Informacion për disa personalitete rome që kanë kontribuar në kulturë, art dhe shoqëri

Më poshtë janë prezantuar shkurtimisht disa personalitete rome të njohura në nivel ndërkombëtar, të cilët kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në art, muzikë, letërsi, aktivizëm dhe mbrojtjen e të drejtave të romëve. Përmes njohjes së tyre, nxënësit kuptojnë se trashëgimia kulturore rome nuk i përket vetëm së kaluarës, por vazhdon të pasurohet dhe të promovohet edhe sot.

Django Reinhardt (1910-1953)

Muzikant dhe kitarist rom me origjinë belge-franceze. Konsiderohet një nga kitaristët më të mëdhenj të shekullit XX dhe themelues i stilit të njohur *Jazz Manouche* (xhazi rom). Pavarësisht një dëmtimi të rëndë në dorë, ai arriti të zhvillonte një teknikë unike që ndikoi në historinë e muzikës botërore.

Esma Rexhepova (1943-2016)

Këngëtare rome nga Maqedonia e Veriut, e njohur si *"Mbretëresha e muzikës rome"*. Gjatë karrierës së saj interpretoi mijëra koncerte në mbarë botën dhe promovoi kulturën rome përmes muzikës. Ajo u angazhua edhe në veprimtari humanitare dhe mbështeti arsimin e fëmijëve romë.

Papusza (Bronisłaëa Wajs) (1908-1987)

Poete rome nga Polonia. Ajo ishte ndër gratë e para rome që botoi krijimet e saj dhe solli në letërsinë evropiane përvojat, traditat dhe ndjenjat e komunitetit rom. Veprat e saj konsiderohen një pasuri e rëndësishme e letërsisë rome.

Mateo Maximoff (1917-1999)

Shkrimtar rom me origjinë franceze. Ai është një nga autorët më të njohur të letërsisë rome dhe ka shkruar romane, tregime dhe studime që pasqyrojnë jetën, historinë dhe kulturën e komunitetit rom. Veprat e tij kanë ndihmuar në njohjen e kulturës rome në mbarë Evropën.

Rajko Duric (1947–2020)

Shkrimtar, studiues dhe aktivist rom nga Serbia. Ai kontribuoi në studimin e historisë dhe kulturës rome dhe ishte një nga mbrojtësit më të njohur të të drejtave të romëve në Evropë. Ka botuar libra, studime dhe artikuj mbi identitetin rom.

Valdemar Kalinin (1973–)

Poet, përkthyes dhe studiues rom nga Bjellorusia. Ai ka kontribuar në zhvillimin e letërsisë bashkëkohore rome dhe në promovimin e gjuhës rome përmes poezisë, studimeve dhe veprimtarive kulturore.

Ian Hancock (1942–)

Gjuhëtar, studiues dhe aktivist rom me origjinë britanike. Ai konsiderohet një nga studiuesit më të njohur të historisë dhe gjuhës rome. Punimet e tij kanë ndihmuar në dokumentimin e historisë së romëve dhe në rritjen e ndërgjegjësimit për diskriminimin ndaj këtij komuniteti.

Kujtim Paçaku (1959–)

Poet, shkrimtar, aktor dhe aktivist rom nga Kosova. Ai është një nga figurat më të njohura të kulturës rome në hapësirën shqiptare dhe ka kontribuar në promovimin e gjuhës, letërsisë dhe identitetit rom përmes krijimtarisë dhe veprimtarisë publike.

4. KLASAT KU MUND TË ZHVILLOHET MODULI "TRASHËGIMIA KULTURORE ROME"

Ky modul mund të zhvillohet në klasën VI ose VII ose VIII ose IX të arsimit të mesëm të ulët. Zbatimi i tij në secilën prej këtyre klasave është i përshtatshëm, pasi njohja dhe vlerësimi i

trashëgimisë kulturore, respektimi i diversitetit dhe edukimi ndërkulturor janë pjesë e formimit qytetar të nxënësve gjatë gjithë arsimit bazë.

Përmbajtja e modulit mbetet e njëjtë në të gjitha klasat, ndërsa ndryshon niveli i thellimit, kompleksiteti i trajtimit dhe lloji i aktiviteteve të përdorura. Kjo i mundëson mësuesit ta përshtatë modulin me moshën, përvojat dhe nivelin e zhvillimit të nxënësve.

Në klasat VI dhe VII, moduli mund të përqendrohet më shumë në njohjen e elementeve bazë të trashëgimisë kulturore rome, si historia e komunitetit rom, gjuha rome, traditat, zakonet, folklori, muzika dhe veshjet tradicionale. Në këtë fazë, nxënësit mund të angazhohen në veprimtari konkrete dhe ndërvepruese, si dëgjimi i tregimeve folklorike, njohja me këngë dhe valle tradicionale, analizimi i fotografive, realizimi i posterave, albumeve ose ekspozitave të thjeshta tematike.

Në klasat VIII dhe IX, moduli mund të trajtohet në mënyrë më të thelluar, duke përfshirë analiza më të zgjeruara të historisë dhe kulturës rome, diskutime mbi rolin e trashëgimisë kulturore në ruajtjen e identitetit, studime krahasuese me kultura të tjera, si dhe reflektime mbi sfidat dhe mundësitë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në botën bashkëkohore. Në këto klasa, nxënësit mund të angazhohen në hulumtime, intervista, projekte digjitale, dokumentim të elementeve të trashëgimisë kulturore dhe aktivitete promovuese që kërkojnë më shumë autonomi dhe mendim kritik.

Zbatimi i modulit në klasat VI–IX u jep nxënësve mundësinë të zhvillojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime që lidhen me respektin për diversitetin kulturor, vlerësimin e trashëgimisë kulturore dhe ndërtimin e marrëdhënieve të bazuara në mirëkuptim, tolerancë dhe bashkëjetesë. Në këtë mënyrë, moduli mund të zbatohet në mënyrë fleksibile nga mësuesi, duke u përshtatur me kontekstin e shkollës, karakteristikat e nxënësve dhe interesat e komunitetit ku zhvillohet.

5. MËSUESIT QË MUND TË ZHVILLOJNË MODULIN "TRASHËGIMIA KULTURORE ROME"

Moduli mund të zhvillohet nga:

- mësues të historisë;
- mësues të gjuhës shqipe;
- mësues të qytetarisë;
- mësues të arteve;
- mësues të gjuhëve të huaja;

- mësues të tjerë që kanë interes dhe njohuri për trashëgiminë kulturore dhe edukimin ndërkulturor.

Mësuesit që zhvillojnë këtë modul:

- duhet të njohin elementet kryesore të historisë, gjuhës, traditave dhe trashëgimisë kulturore rome;
- duhet të promovojnë respektin për diversitetin kulturor, gjuhësor dhe etnik, duke shmangur stereotipet dhe paragjykimet;
- duhet të krijojnë një mjedis mësimor të sigurt, gjithëpërfshirës dhe respektues, ku çdo nxënës të ndihet i vlerësuar dhe i pranuar;
- duhet të nxisin dialogun ndërkulturor, bashkëpunimin dhe mirëkuptimin ndërmjet nxënësve;
- duhet të përdorin burime të larmishme informacioni, materiale autentike dhe shembuj konkretë që pasqyrojnë kulturën dhe historinë rome;
- duhet të përdorin metoda mësimdhënieje ndërvepruese, që nxisin pjesëmarrjen aktive, reflektimin dhe mendimin kritik të nxënësve;
- duhet të inkurajojnë vlerësimin e trashëgimisë kulturore si një pasuri e përbashkët që kontribuon në identitetin dhe diversitetin kulturor të shoqërisë;
- duhet të përdorin mjete dhe platforma digjitale për hulumtimin, dokumentimin, promovimin dhe prezantimin e elementeve të trashëgimisë kulturore rome;
- duhet të bashkëpunojnë, kur është e mundur, me përfaqësues të komunitetit rom, institucione kulturore, muze, organizata dhe aktorë të tjerë që kontribuojnë në ruajtjen dhe promovimin e kulturës rome.

Në zhvillimin e këtij moduli, mësuesi merr rolin e lehtësuesit dhe udhëheqësit të procesit të të nxënit, duke i ndihmuar nxënësit të njohin, të kuptojnë dhe të vlerësojnë trashëgiminë kulturore rome si pjesë të trashëgimisë kulturore të Shqipërisë dhe të Evropës.

6. KOHËZGJATJA E MODULIT "TRASHËGIMIA KULTURORE ROME"

Moduli "Trashëgimia kulturore rome" zhvillohet në 35 orë mësimore. Përmbajtja e modulit mbetet e njëjtë në të gjitha klasat e arsimit të mesëm të ulët, ndërsa ndryshon niveli i thellimit të njohurive, kompleksiteti i aktiviteteve dhe mënyra e trajtimit të tematikave, në varësi të moshës, interesave dhe përvojave të nxënësve.

Mësuesi ka mundësi të përshtatë numrin e orëve për secilën tematikë, llojin e veprimtarive dhe mënyrën e organizimit të punës, sipas karakteristikave të klasës dhe ritmit të të nxënit të

nxënësve. Në këtë mënyrë, moduli mund të zbatohet në mënyrë fleksibile në kontekste të ndryshme shkollore, duke ruajtur objektivat dhe përmbajtjen e tij kryesore.

Gjatë zhvillimit të modulit, nxënësit angazhohen në veprimtari të ndryshme, si kërkime, diskutime, analiza materialesh, intervista, projekte krijuese, përdorim të burimeve digjitale dhe prezantime, të cilat u mundësojnë të njohin dhe të vlerësojnë elemente të ndryshme të trashëgimisë kulturore rome.

Duke qenë se moduli zhvillohet në kuadër të kurrikulës në bazë shkolle, ai nuk vlerësohet me notë. Vlerësimi mbështetet në pjesëmarrjen aktive, angazhimin, bashkëpunimin dhe përfshirjen e nxënësve në veprimtaritë e modulit, si dhe në realizimin e detyrave dhe të produktit përfundimtar.

Vlerësimi zhvillohet kryesisht si *vlerësim për të nxënë*, përmes vëzhgimit të vazhdueshëm, komenteve, sugjerimeve për përmirësim, reflektimit individual dhe në grup, si dhe vlerësimit të dhënë nga mësuesi dhe bashkëmoshatarët. Ky proces synon të mbështesë të nxënit, të nxisë reflektimin dhe të ndihmojë nxënësit të përmirësojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e tyre në lidhje me trashëgiminë kulturore rome.

Në përfundim të modulit, nxënësit prezantojnë një produkt individual ose në grup, përmes të cilit demonstrojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e zhvilluara gjatë modulit, si dhe aftësinë për të promovuar dhe vlerësuar trashëgiminë kulturore rome si pjesë të trashëgimisë kulturore të Shqipërisë dhe të Evropës.

7. REZULTATET E TË NXËNIT

Gjatë zhvillimit të modulit "Trashëgimia kulturore rome", nxënësi:

- përshkruan origjinën dhe zhvillimin historik të komunitetit rom;
- shpjegon migrimet historike të romëve dhe shpërndarjen e tyre në Evropë dhe në Shqipëri;
- identifikon ngjarje dhe periudha të rëndësishme në historinë e komunitetit rom;
- vlerëson kontributin e komunitetit rom në jetën shoqërore, kulturore dhe artistike;
- dallon veçoritë kryesore të gjuhës rome si pjesë e identitetit kulturor rom;
- përdor fjalë dhe shprehje të thjeshta në gjuhën rome në situata të përshtatshme komunikimi;
- shpjegon rëndësinë e gjuhës rome në ruajtjen dhe transmetimin e trashëgimisë kulturore;
- përshkruan traditat, zakonet dhe mënyrën e jetesës së komunitetit rom;
- krahason elemente të kulturës rome me elemente të kulturës shqiptare dhe kulturave të tjera;
- identifikon vlerat që përcillen përmes traditave dhe zakoneve rome;
- përshkruan elementet kryesore të krijimtarisë folklorike rome;

- dallon lloje të ndryshme të folklorit rom, si përrallat, legjendat, proverbat dhe tregimet popullore;
- analizon mesazhet dhe vlerat që përcillen përmes krijimtarisë folklorike rome;
- identifikon karakteristikat kryesore të muzikës, vallëzimit dhe arteve të tjera rome;
- shpjegon rolin e muzikës dhe të arteve në ruajtjen e identitetit kulturor rom;
- vlerëson kontributin e artistëve romë në kulturën shqiptare dhe evropiane;
- përshkruan zejet tradicionale rome dhe rëndësinë e tyre në jetën e komunitetit;
- identifikon elemente karakteristike të veshjeve tradicionale rome;
- shpjegon lidhjen ndërmjet zejeve, veshjeve tradicionale dhe identitetit kulturor;
- përdor burime të ndryshme informacioni për të hulumtuar elemente të trashëgimisë kulturore rome;
- kërkon, përzgjedh, organizon dhe interpreton informacion nga burime të shkruara, pamore dhe digjitale;
- realizon hulumtime individuale ose në grup për tema që lidhen me kulturën rome;
- përdor mjete dhe platforma digjitale për dokumentimin dhe prezantimin e informacionit;
- krijon produkte të ndryshme informuese dhe promovuese për trashëgiminë kulturore rome;
- prezanton gjetjet dhe përfundimet e hulumtimeve të realizuara;
- komunikon në mënyrë të qartë dhe të argumentuar gjatë prezantimeve dhe diskutimeve;
- bashkëpunon me të tjerët gjatë realizimit të detyrave dhe projekteve;
- respekton mendimet, përvojat dhe kulturat e ndryshme gjatë punës në grup;
- shfaq qëndrime pozitive ndaj diversitetit kulturor dhe gjuhësor;
- identifikon dhe kundërshton stereotipet dhe paragjykimet që lidhen me komunitetin rom;
- vlerëson rëndësinë e dialogut ndërkulturor dhe të bashkëjetesës në një shoqëri demokratike;
- argumenton rëndësinë e ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore rome;
- reflekton mbi njohuritë dhe përvojat e fituara gjatë zhvillimit të modulit;
- vlerëson punën e vet dhe të bashkëmoshatarëve përmes komenteve, sugjerimeve dhe reflektimit konstruktiv;
- propozon mënyra konkrete për promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore rome në shkollë dhe në komunitet.

8. VEPRIMTARI PRAKTIKE PËR ZHVILLIMIN E MODULIT "TRASHËGIMIA KULTURORE ROME"

Më poshtë janë përshkruar disa veprimtari sugjeruese praktike, të cilat janë grupuar sipas tematikave të modulit. Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin disa prej tyre, t'i përshtatin sipas nevojave të klasës ose të planifikojnë veprimtari të reja, në funksion të përmbushjes së rezultateve të pritshme të modulit.

TEMATIKA 1: HISTORIA E ROMËVE

1) Udhëtimi i gjatë

Mësuesi paraqet në tabelë ose në ekran një hartë të madhe të Evropës, Azisë dhe Lindjes së Mesme. Nxënësit marrin informacion të shkurtër për origjinën e romëve dhe migrimet e tyre ndër shekuj.

Në grupe, nxënësit identifikojnë vendet dhe rajonet kryesore nëpër të cilat kanë kaluar romët gjatë migrimit të tyre historik. Çdo grup vendos në hartë etiketa, shigjeta dhe shënime të shkurtra që tregojnë rrugët e lëvizjes.

Në fund, grupet prezantojnë "udhëtimin" e komunitetit rom dhe diskutojnë:

- Pse popujt migrojnë?
- Si ndikojnë migrimet në gjuhë dhe kulturë?
- Si ruhet identiteti kulturor gjatë lëvizjeve të gjata historike?

2) Dosja e historianit

Mësuesi sjell materiale të ndryshme historike: fotografi, dokumente, harta, citime, fragmente tekstesh dhe të dhëna statistikore.

Nxënësit punojnë në grupe si historianë. Ata analizojnë materialet dhe përpiqen të rindërtojnë historinë e romëve duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Nga kanë ardhur?
- Kur janë vendosur në Evropë?
- Me çfarë janë marrë tradicionalisht?
- Çfarë vështirësish kanë hasur gjatë historisë?

Çdo grup përgatit një "dosje historike" dhe i prezanton përfundimet para klasës.

3) Linja e kohës

Mësuesi paraqet ngjarje të rëndësishme nga historia e romëve të përziera pa rend kronologjik.

Në grupe, nxënësit duhet t'i organizojnë në një linjë kohore duke filluar nga origjina e romëve deri në ditët e sotme.

Më pas diskutojnë:

- Cilat ngjarje kanë ndikuar më shumë në historinë e komunitetit rom?
- Cilat periudha kanë qenë më të vështira?
- Si ka ndryshuar jeta e romëve me kalimin e kohës?

Në fund krijohet një linjë e madhe kohore e përbashkët për klasën.

4) Një ditë në këpucët e tyre

Nxënësve u jepen skenarë të shkurtër të bazuar në situata historike reale nga periudha të ndryshme. P.sh.:

- një familje rome gjatë migrimit;
- një zejtar rom në Ballkan;
- një muzikant rom në një qytet evropian;
- një fëmijë rom që shkon për herë të parë në shkollë.

Nxënësit diskutojnë në grup:

- çfarë sfidash mund të ketë pasur personazhi?
- çfarë ndjenjash mund të ketë përjetuar?
- si do të vepronin ata në të njëjtën situatë?

Veprimtaria ndihmon në kuptimin e historisë përmes empatisë.

5) Mitet dhe faktet

Mësuesi paraqet pohime të ndryshme për romët.

Shembuj:

Pohimi	**Mit/Fakt**
Romët kanë origjinë nga India.	*Fakt*
Të gjithë romët jetojnë në të njëjtën mënyrë.	*Mit*
Romët nuk kanë gjuhën e tyre.	*Mit*
Muzika rome ka ndikuar në kulturën evropiane.	*Fakt*
Të gjithë romët janë nomadë.	*Mit*
Romët jetojnë në shumë vende të botës.	*Fakt*
Komunitetet rome kanë tradita dhe zakone të ndryshme.	*Fakt*
Gjuha rome ka disa dialekte.	*Fakt*
Të gjithë romët flasin gjuhën rome.	*Mit*

Romët kanë kontribuar në muzikë, art dhe letërsi.	*Fakt*
Kultura rome është pjesë e trashëgimisë kulturore evropiane.	*Fakt*
Romët kanë të njëjtën fe kudo ku jetojnë.	*Mit*
Flamuri dhe himni rom janë simbole ndërkombëtare të komunitetit rom.	*Fakt*
Të gjithë romët merren me të njëjtat profesione.	*Mit*
Folklori rom përfshin përralla, legjenda, këngë dhe proverba.	*Fakt*
Traditat rome kanë mbetur të pandryshuara gjatë historisë.	*Mit*
UNESCO mbështet ruajtjen dhe promovimin e gjuhës rome.	*Fakt*
Romët kanë qenë pjesë e historisë së Ballkanit prej shekujsh.	*Fakt*

Nxënësit vendosin nëse pohimi është fakt apo mit dhe argumentojnë përgjigjen duke përdorur informacionin e mësuar.

Në fund ndërtohet një tabelë me dy kolona:

Çfarë mendonim më parë?	**Çfarë mësuam?**

Kjo veprimtari është shumë e dobishme për të luftuar stereotipet dhe paragjykimet.

6) Gazetarët e historisë

Nxënësit ndahen në grupe dhe imagjinojnë se janë gazetarë që raportojnë nga periudha të ndryshme të historisë së romëve.

Çdo grup përgatit një kronikë të shkurtër duke iu përgjigjur pyetjeve:

- Çfarë po ndodh?
- Ku po ndodh?
- Kush janë personazhet kryesore?
- Pse kjo ngjarje është e rëndësishme?

Më pas realizojnë një prezantim në stilin e një lajmi televiziv historik.

7) Harta e kontributeve

Në një hartë të madhe të Evropës nxënësit vendosin informacione për kontributet e komuniteteve rome në vende të ndryshme.

P.sh.:

- flamenco në Spanjë;

- muzikantët romë në Hungari;
- traditat rome në Ballkan;
- artistë dhe personalitete rome.

Në fund diskutohet se si kultura rome është bërë pjesë e trashëgimisë kulturore evropiane.

TEMATIKA 2: GJUHA ROME

1) Gjurmët e një gjuhe

Mësuesi paraqet disa fjalë të thjeshta në gjuhën rome (p.sh. numra, përshëndetje, emra familjarë, pjesë të trupit) së bashku me përkthimet përkatëse. Nxënësit punojnë në grupe dhe përpiqen të gjejnë ngjashmëri ose dallime mes këtyre fjalëve dhe fjalëve në shqip apo në gjuhë të tjera që njohin.

Më pas, mësuesi shpjegon shkurtimisht prejardhjen e gjuhës rome dhe lidhjen e saj me gjuhët indo-ariane. Nxënësit diskutojnë rreth pyetjeve?

- Çfarë mund të mësojmë për historinë e një populli përmes gjuhës?
- Pse gjuha konsiderohet pjesë e identitetit kulturor;
- Çfarë ndodh kur një gjuhë nuk përdoret më.

Në fund, klasa krijon një poster me titull *"Gjuha tregon historinë"*.

2) Fjalori i vogël rom-shqip

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup merr një kategori fjalësh:

- familja;
- numrat;
- ngjyrat;
- ushqimet;
- pjesët e trupit;
- përshëndetjet.

Duke përdorur materiale të përgatitura nga mësuesi, grupet ndërtojnë një fjalorth të vogël rom-shqip.

Për secilën fjalë përfshijnë:

- fjalën në gjuhën rome;
- përkthimin në shqip;
- një ilustrim ose simbol.

Në fund, të gjitha fletët bashkohen në një fjalorth të përbashkët të klasës.

3) *Si tingëllon gjuha rome?*

Mësuesi paraqet një regjistrim audio ose video të shkurtër në gjuhën rome.

Gjatë dëgjimit, nxënësit mbajnë shënime për:

- tingujt që u duken të njohur;
- fjalët që mund të kuptojnë;
- ritmin dhe intonacionin e gjuhës.

Pas dëgjimit zhvillohet diskutim:

- Si ju tingëlloi gjuha?
- Çfarë ngjashmërish vutë re me gjuhë të tjera?
- Pse është e rëndësishme të dëgjojmë dhe të njohim gjuhë të ndryshme?

Veprimtaria synon të zhvillojë kuriozitetin dhe respektin ndaj diversitetit gjuhësor.

4) *Fjalët që udhëtojnë*

Mësuesi paraqet shembuj fjalësh të gjuhës rome që kanë ngjashmëri me fjalë të gjuhëve të tjera.

Nxënësit analizojnë shembujt dhe kuptojnë se gjuhët ndikojnë njëra-tjetrën gjatë historisë.

Në grupe, ata krijojnë një diagram ku paraqesin:

- gjuhën rome;
- gjuhët me të cilat ka pasur kontakte;
- shembuj fjalësh të huazuara.

Në fund diskutohet se si migrimet dhe bashkëjetesa ndikojnë në zhvillimin e gjuhëve.

5) *Mesazhi shumëgjuhësh*

Nxënësit përgatisin një kartolinë ose mesazh të shkurtër që përmban:

- një përshëndetje në gjuhën rome;
- një përshëndetje në shqip;
- një përshëndetje në një gjuhë tjetër që njohin.

Më pas prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë:

- sa gjuhë njohin nxënësit në klasë;
- pse shumëgjuhësia është pasuri;
- si ndihmon njohja e gjuhëve në komunikim dhe mirëkuptim.

6) *Gjuha dhe identiteti*

Mësuesi paraqet situatën: *Një komunitet ndalon së përdoruri gjuhën e vet për shumë vite. Çfarë mund të ndodhë me kulturën e tij?*

Nxënësit punojnë në grupe dhe diskutojnë rreth pyetjeve:

- Çfarë humbet kur humbet një gjuhë?
- Çfarë ruan gjuha?
- Pse komunitetet përpiqen të mbrojnë gjuhët e tyre?

Në fund, secili grup paraqet përfundimet dhe klasa harton një listë me arsyet pse gjuha rome është e rëndësishme për identitetin kulturor rom.

7) Reporterët e gjuhës

Nxënësit imagjinojnë se janë reporterë që po përgatisin një kronikë mbi gjuhën rome. Në grupe, ata përgatisin një prezantim të shkurtër ku shpjegojnë:

- Çfarë është gjuha rome?
- Nga e ka origjinën?
- Ku flitet sot?
- Pse duhet ruajtur?

Prezantimi mund të realizohet në formë videoje, interviste ose lajmi televiziv. Në fund, nxënësit reflektojnë mbi rolin që kanë shkollat dhe shoqëria në ruajtjen e gjuhëve minoritare dhe të trashëgimisë gjuhësore.

TEMATIKA 3: TRADITAT, ZAKONET DHE MËNYRA E JETESËS

1) Familja - qendra e jetës rome

Mësuesi prezanton informacione mbi rolin e familjes në kulturën rome. Shpjegohet se familja ka qenë tradicionalisht institucioni më i rëndësishëm shoqëror, ku fëmijët rriten duke mësuar gjuhën, traditat, zakonet dhe vlerat e komunitetit. Në shumë familje rome, gjyshërit dhe të afërmit luajnë rol të rëndësishëm në edukimin e brezave të rinj.

Pas diskutimit, nxënësit punojnë në grupe dhe ndërtojnë një hartë konceptuale me titull "*Çfarë funksionesh ka familja?"* duke krahasuar familjen rome me familjen shqiptare.

Në fund, grupet prezantojnë punën e tyre dhe nxjerrin përfundime mbi rëndësinë e familjes në ruajtjen e identitetit kulturor.

2) Traditat që kalojnë nga brezi në brez

Mësuesi shpjegon se shumë tradita rome janë ruajtur përmes transmetimit gojor dhe shembullit familjar. Për shumë kohë, njohuritë për zakonet, ceremonitë, këngët dhe mënyrën e jetesës janë përcjellë nga të moshuarit te brezat e rinj.

Nxënësit analizojnë disa shembuj traditash rome dhe identifikojnë:

- Kush i transmeton ato?

- Si ruhen?
- Pse vazhdojnë të ekzistojnë edhe sot?

Më pas krijojnë një skemë me titull "*Si mbijeton një traditë?*"?

3) Mikpritja si vlerë kulturore

Mësuesi prezanton materiale mbi mikpritjen në komunitetin rom. Shpjegohet se respekti ndaj mysafirit dhe gatishmëria për ta pritur atë janë vlera që gjenden në shumë komunitete rome, ashtu si edhe në kulturën shqiptare.

Nxënësit lexojnë situata të ndryshme dhe vendosin:

- Cilat sjellje tregojnë mikpritje?
- Cilat tregojnë mungesë respekti?
- Pse mikpritja konsiderohet vlerë e rëndësishme shoqërore?

Në fund hartojnë një "Kod të mikpritjes".

4) Festat në jetën e komunitetit rom

Mësuesi paraqet informacion mbi festat familjare dhe komunitare në kulturën rome. Shpjegohet se festat janë raste kur forcohen lidhjet familjare, ruhen traditat dhe përcillen vlerat kulturore.

Në grupe, nxënësit analizojnë fotografi dhe materiale informuese dhe plotësojnë një tabelë:

Festa	Çfarë festohet?	Si festohet?	Cilat tradita ruhen?

Në fund diskutojnë rolin që kanë festat në ruajtjen e identitetit kulturor.

5) Një traditë, shumë kuptime

Mësuesi paraqet disa tradita rome që lidhen me familjen, festat ose jetën e përditshme.

Nxënësit analizojnë secilën traditë dhe diskutojnë:

- Çfarë vlere përcjell?
- Pse është krijuar?
- A ka një traditë të ngjashme në kulturën shqiptare?

Më pas plotësojnë një diagram të Venit për të krahasuar traditat.

6) Si ka ndryshuar mënyra e jetesës?

Mësuesi shpjegon se mënyra e jetesës së romëve ka ndryshuar me kalimin e kohës për shkak të urbanizimit, arsimit, teknologjisë dhe integrimit në shoqëri.

Nxënësit ndahen në grupe dhe analizojnë dy situata:

- një familje rome në të kaluarën;
- një familje rome sot.

Më pas plotësojnë tabelën:

Dikur	**Sot**

Në fund diskutojnë cilat tradita janë ruajtur dhe cilat kanë ndryshuar.

7) Albumi i jetës së përditshme

Mësuesi paraqet fotografi që lidhen me jetën e përditshme të komuniteteve rome.

Nxënësit analizojnë:

- veshjen;
- mjedisin familjar;
- aktivitetet;
- marrëdhëniet mes njerëzve.

Më pas secili grup krijon një faqe albumi me titull: "*Një ditë në jetën e një komuniteti rom"*, duke shoqëruar fotografitë me komente dhe shpjegime.

8) Vlerat që na bashkojnë

Si veprimtari përmbyllëse, nxënësit identifikojnë vlera që gjenden si në kulturën rome ashtu edhe në kulturën shqiptare:

- respekti për familjen;
- mikpritja;
- solidariteti;
- respekti për të moshuarit;
- ruajtja e traditave.

Në grupe krijojnë një poster ose infografik me titull: "*Vlera të përbashkëta, kultura të ndryshme",* dhe prezantojnë përfundimet para klasës.

Kjo tematikë duhet të përqendrohet më shumë te vlerat, mënyra e jetesës dhe identiteti kulturor, sesa te folklori, muzika apo veshjet, sepse këto trajtohen më vete në tematika të tjera.

TEMATIKA 4: KRIJIMTARIA FOLKLORIKE ROME

Kjo tematikë synon t'i njohë nxënësit me pasurinë e folklorit rom si pjesë e trashëgimisë kulturore jomateriale. Përmes përrallave, legjendave, proverbave, gjëegjëzave dhe tregimeve popullore, romët kanë ruajtur historinë, përvojat, vlerat dhe mënyrën e tyre të të kuptuarit të botës. Krijimtaria folklorike ka qenë për shekuj një nga mënyrat kryesore për transmetimin e kulturës nga një brez te tjetri.

1) Udhëtim në botën e përrallave rome

Mësuesi prezanton një ose dy përralla tradicionale rome. Para leximit, nxënësit njihen shkurtimisht me faktin se folklori rom është zhvilluar kryesisht përmes traditës gojore dhe se përrallat kanë luajtur rol të rëndësishëm në edukimin e fëmijëve dhe ruajtjen e kujtesës kulturore.

Pas leximit, nxënësit punojnë në grupe dhe analizojnë:

- personazhet kryesore;
- konfliktin;
- mënyrën si zgjidhet problemi;
- mesazhin që përcjell përralla.

Në fund, grupet diskutojnë se cilat vlera promovohen në tregim dhe pse ato kanë qenë të rëndësishme për komunitetin rom.

2) Çfarë na mësojnë proverbat rome?

Mësuesi paraqet një përzgjedhje proverbash rome të përkthyera në shqip.

Shembujt analizohen së bashku dhe nxënësit përpiqen të zbulojnë kuptimin e tyre.

Më pas, në grupe:

- interpretojnë proverbat;
- gjejnë situata ku ato mund të përdoren;
- kërkojnë proverba shqiptare me kuptim të ngjashëm.

Në fund ndërtohet një tabelë krahasuese:

Proverb rom	**Kuptimi**	**Proverb i ngjashëm shqiptar**

Veprimtaria ndihmon nxënësit të kuptojnë se shumë vlera njerëzore janë të përbashkëta në kultura të ndryshme.

3) *Legjendat që ruajnë kujtesën*

Mësuesi shpjegon dallimin ndërmjet përrallës dhe legjendës dhe prezanton një legjendë rome.

Nxënësit analizojnë:

- elementet reale;
- elementet fantastike;
- mesazhin e legjendës;
- arsyen pse komunitetet krijojnë legjenda.

Në fund krijojnë një diagram ku ndajnë faktet historike nga elementet legjendare.

4) *Folklori në role*

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup merr një tregim ose përrallë rome.

Ata përgatisin një dramatizim të shkurtër duke ruajtur personazhet, ngjarjet dhe mesazhin e tregimit.

Pas interpretimit, klasa diskuton:

- Cilat vlera u përcollën?
- Cili personazh ishte më interesant?
- Çfarë mund të mësojmë nga tregimi?

Kjo veprimtari i ndihmon nxënësit të përjetojnë folklorin në mënyrë aktive.

5) *Gjëegjëzat*

Mësuesi prezanton disa gjëegjëza tradicionale rome.

Nxënësit përpiqen t'i zgjidhin individualisht ose në grupe dhe më pas analizojnë:

- Çfarë objektesh ose dukurish përshkruhen?
- Cilat aftësi mendore kërkon zgjidhja e tyre?
- Pse gjëegjëzat kanë qenë të rëndësishme në traditën gojore?

Në fund, grupet krijojnë gjëegjëza të reja të frymëzuara nga modelet tradicionale.

6) *Hartë e personazheve folklorike*

Mësuesi prezanton personazhe të ndryshme që shfaqen në folklorin rom:

- njeriu i mençur;
- udhëtari;
- i varfri që triumfon;
- mashtruesi;
- personazhe fantastike.

Nxënësit ndërtojnë një hartë konceptuale ku përshkruajnë:

- tiparet e personazheve;
- rolin e tyre në tregime;
- vlerat që përfaqësojnë.

Në fund diskutohet pse personazhe të ngjashme gjenden edhe në folklorin shqiptar dhe atë botëror.

7) Mesazhet e folklorit

Mësuesi shpjegon se folklori nuk shërben vetëm për argëtim.

Nxënësit analizojnë disa tregime të shkurtra dhe identifikojnë se:

- çfarë vlere përcillet;
- çfarë sjelljeje kritikohet;
- çfarë këshille jep tregimi.

Më pas plotësojnë një tabelë:

Tregimi	**Mesazhi**	**Vlera që promovon**

Kjo veprimtari i ndihmon nxënësit të kuptojnë funksionin estetik dhe human të folklorit.

8) Nga tradita gojore te arkivi digjital

Si veprimtari përmbyllëse e tematikës, nxënësit përzgjedhin një përrallë, proverb, legjendë ose gjëegjëzë rome dhe e dokumentojnë në formë digjitale.

Ata:

- mund të regjistrojnë leximin e saj;
- mund të krijojnë ilustrime;
- mund të realizojnë një prezantim të shkurtër;
- mund të përgatisin një faqe informuese.

Materialet ruhen në dosjen ose arkivin digjital të modulit dhe do të përdoren më pas në produktin final. Në fund, nxënësit reflektojnë mbi pyetjen:

"Çfarë do të humbnim nëse këto tregime nuk do të përcilleshin më te brezat e rinj?"

Kjo i ndihmon të kuptojnë rëndësinë e folklorit në ruajtjen e identitetit kulturor dhe të kujtesës kolektive.

TEMATIKA 5: MUZIKA, VALLËZIMI DHE ARTET E TJERA ROME

Muzika dhe vallëzimi zënë një vend të veçantë në kulturën rome dhe konsiderohen ndër elementet më të njohura të trashëgimisë së saj kulturore. Në shumë vende të Evropës, artistët romë kanë ndikuar në zhvillimin e muzikës popullore dhe profesionale, ndërsa këngët dhe vallet tradicionale vazhdojnë të jenë pjesë e rëndësishme e festave dhe e jetës komunitare. Krahas muzikës dhe vallëzimit, romët kanë dhënë kontribut edhe në fusha të tjera artistike, si letërsia, piktura, teatri dhe kinematografia.

1) Muzika që tregon histori

Mësuesi prezanton një ose disa pjesë muzikore rome nga vende të ndryshme të Evropës. Para dëgjimit, nxënësit njihen me faktin se muzika rome shpesh pasqyron përvoja jetësore, emocione, udhëtime, dashuri, mall dhe gëzim.

Gjatë dëgjimit, nxënësit mbajnë shënime:

- për emocionet që u përcjell muzika;
- për ritmin;
- për instrumentet që dallojnë;
- për atmosferën që krijohet.

Pas dëgjimit, zhvillohet një diskutim mbi mënyrën se si muzika mund të tregojë histori edhe pa përdorur fjalë.

2) Zbulo instrumentin

Mësuesi prezanton fotografi, video ose regjistrime zanore të instrumenteve që përdoren shpesh nga muzikantët romë, si:

- violina;
- klarineta;
- fizarmonika;
- kitara;
- daullja;
- cimbali.

Nxënësit punojnë në grupe dhe për secilin instrument përgatisin një kartelë informuese ku përfshijnë:

- emrin;
- pamjen;
- tingullin;

- përdorimin në muzikën rome.

Në fund organizohet një ekspozitë e vogël me kartelat e përgatitura.

3) Nga Spanja në Ballkan

Mësuesi shpjegon se kultura rome ka ndikuar në forma të ndryshme muzikore në vende të ndryshme. Nxënësit ndahen në grupe dhe çdo grup studion një rast:

- flamenco në Spanjë;
- muzika rome në Hungari;
- orkestrat rome në Rumani;
- muzika rome në Maqedoni.
- Etj.

Çdo grup përgatit një prezantim të shkurtër ku tregon:

- karakteristikat kryesore;
- instrumentet;
- ndikimin e muzikantëve romë.

Në fund ndërtohet një hartë e Evropës ku vendosen kontributet muzikore të komuniteteve rome.

4) Lexojmë një këngë

Mësuesi paraqet tekstin e një kënge tradicionale rome të përkthyer në shqip.

Nxënësit analizojnë:

- temën;
- emocionet që shpreh;
- mesazhin;
- figurat dhe simbolet e përdorura.

Më pas diskutojnë:

- Për çfarë këndojnë njerëzit?
- Pse këngët janë pjesë e rëndësishme e kujtesës kulturore?

Në fund nxënësit shkruajnë një reflektim të shkurtër mbi mesazhin e këngës.

5) Gjuha e vallëzimit

Mësuesi prezanton video të shkurtra me valle tradicionale rome.

Para vëzhgimit, nxënësit njihen me faktin se vallëzimi rom karakterizohet nga energjia, improvizimi dhe shprehja e emocioneve.

Gjatë vëzhgimit ata analizojnë:

- lëvizjet;

- ritmin;
- përdorimin e kostumeve;
- ndërveprimin mes valltarëve.

Më pas diskutojnë:

- Çfarë emocionesh përcjell vallja?
- Çfarë roli ka vallëzimi në festa dhe ceremoni?
- Si ndryshon vallja rome nga vallet që ata njohin?

6) Artistë romë që kanë lënë gjurmë

Mësuesi prezanton artistë romë të njohur në muzikë, teatër, letërsi ose arte pamore.

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup hulumton për një artist.

Për secilin artist identifikojnë:

- jetën dhe veprimtarinë;
- fushën ku ka kontribuar;
- ndikimin që ka pasur.

Në fund organizohet një galeri prezantimesh me titull: "*Artistët romë dhe kontributi i tyre në kulturë*".

7) Galeria e arteve rome

Mësuesi prezanton shembuj të artit rom:

- piktura;
- ilustrime;
- fotografi;
- skulptura;
- punime artizanale me vlera artistike.

Nxënësit analizojnë veprat dhe identifikojnë:

- ngjyrat dominuese;
- temat;
- simbolet;
- emocionet që përcjellin.

Më pas krijojnë një fletë analize artistike për veprën që u ka bërë më shumë përshtypje.

8) Festivali kulturor rom

Si veprimtari përmbyllëse e tematikës, klasa organizon një festival simbolik kulturor.

Grupet përgatisin kënde të ndryshme ku prezantojnë:

- muzikë rome;
- valle tradicionale;
- artistë romë;
- instrumente muzikore;
- arte të tjera.

Secili grup shpjegon rëndësinë e elementit që prezanton dhe mënyrën se si ai kontribuon në ruajtjen e identitetit kulturor rom.

Në fund zhvillohet një diskutim reflektues: *"Pse muzika dhe arti janë ndër elementet më të dukshme dhe më të njohura të kulturës rome?"*

Kjo veprimtari shërben si urë lidhëse mes njohurive të fituara dhe produktit final të modulit.

TEMATIKA 6: ZEJET DHE VESHJET TRADICIONALE ROME

Zejet dhe veshjet tradicionale janë pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore materiale të komunitetit rom. Për shekuj me radhë, romët janë dalluar për aftësitë e tyre në zanate të ndryshme, si përpunimi i metaleve, farkëtaria, kallajisja, punimet me dru dhe tregtia e produkteve artizanale. Këto profesione jo vetëm kanë siguruar jetesën e familjeve rome, por kanë kontribuar edhe në zhvillimin ekonomik dhe kulturor të zonave ku ata kanë jetuar. Po ashtu, veshjet tradicionale rome, me ngjyrat e tyre të gjalla dhe zbukurimet karakteristike, përbëjnë një element të rëndësishëm të identitetit kulturor rom.

1) Zejtarët e dikurshëm

Mësuesi prezanton materiale informuese dhe fotografi që tregojnë zanatet tradicionale të ushtruara nga komunitetet rome në vende të ndryshme të Evropës dhe në Shqipëri.

Nxënësit njihen me profesione si:

- farkëtari;
- kallajisja;
- përpunimi i bakrit;
- punimet me dru;
- riparimi i enëve dhe i veglave;
- tregtia ambulante.

Në grupe, nxënësit plotësojnë një tabelë:

Zeja	Çfarë prodhohej?	Pse ishte e rëndësishme?

Në fund diskutojnë se si këto profesione ndihmonin komunitetin dhe pse disa prej tyre janë zhdukur ose janë transformuar sot.

2) Një objekt, një histori

Mësuesi paraqet fotografi të objekteve të ndryshme artizanale të krijuara ose të përdorura nga komunitetet rome.

Nxënësit zgjedhin një objekt dhe përpiqen të zbulojnë:

- nga çfarë materiali është realizuar;
- si është prodhuar;
- për çfarë përdorej;
- çfarë tregon për mënyrën e jetesës së njerëzve.

Më pas secili grup prezanton objektin si një "*dëshmitar*" të historisë dhe kulturës rome.

3) Nga zeja tradicionale te profesioni modern

Mësuesi shpjegon se shumë zanate tradicionale rome kanë ndryshuar me zhvillimin e teknologjisë dhe industrisë. Nxënësit punojnë në grupe dhe krahasojnë:

- një zeje tradicionale;
- profesionin modern që ka zëvendësuar ose transformuar atë.

Në fund diskutojnë:

- Çfarë fitohet nga modernizimi?
- Çfarë humbet kur zhduken zanatet tradicionale?
- Pse është e rëndësishme të ruhen disa nga njohuritë artizanale?

4) Veshjet që tregojnë identitetin

Mësuesi prezanton fotografi të veshjeve tradicionale rome nga vende të ndryshme.

Nxënësit analizojnë:

- ngjyrat;
- modelet dekorative;
- materialet;
- stolitë.

Më pas identifikojnë elementet që i bëjnë këto veshje të dallueshme dhe diskutojnë pse veshja konsiderohet pjesë e identitetit kulturor.

5) Detektivët e veshjes

Secilit grup i jepet një fotografi e një veshjeje tradicionale rome.

Nxënësit duhet të zbulojnë:

- Kujt i përket veshja?
- Në çfarë rastesh përdoret?
- Çfarë simbolizon?
- Cilat elemente dekorative bien më shumë në sy?

Në fund grupet prezantojnë analizën e tyre dhe krahasojnë gjetjet.

6) Ngjashmëri dhe dallime

Mësuesi paraqet fotografi të veshjeve tradicionale rome dhe shqiptare.

Nxënësit plotësojnë një diagram të Venit duke identifikuar:

- elementet e përbashkëta;
- dallimet;
- ndikimet e mundshme kulturore.

Në fund zhvillohet një diskutim mbi mënyrën se si kulturat ndikojnë njëra-tjetrën gjatë bashkëjetesës.

7) Projektues të modës tradicionale

Pas njohjes me veshjet tradicionale rome, nxënësit krijojnë një skicë të një veshjeje të frymëzuar nga elemente autentike të kulturës rome.

Në skicë duhet të përfshijnë:

- ngjyrat karakteristike;
- motive dekorative;
- stoli ose aksesorë;
- shpjegimin e zgjedhjeve të tyre.

Në fund organizohet një ekspozim i punimeve dhe nxënësit argumentojnë idetë e tyre.

8) Trashëgimia që duhet ruajtur

Si veprimtari përmbyllëse, mësuesi udhëheq një diskutim mbi sfidat me të cilat përballen sot zanatet dhe veshjet tradicionale.

Nxënësit punojnë në grupe dhe hartojnë propozime konkrete për:

- ruajtjen e zanateve tradicionale;
- promovimin e veshjeve tradicionale;
- përfshirjen e tyre në aktivitete kulturore;
- dokumentimin e tyre për brezat e ardhshëm.

Në fund secili grup prezanton idetë e veta dhe klasa harton një listë me rekomandime për mbrojtjen e kësaj pjese të trashëgimisë kulturore rome.

Kjo tematikë i ndihmon nxënësit të kuptojnë se zejet dhe veshjet tradicionale nuk janë thjesht elemente të së kaluarës, por dëshmi të historisë, identitetit dhe krijimtarisë së një komuniteti, të cilat meritojnë të njihen, të vlerësohen dhe të ruhen.

TEMATIKA 7: TRASHËGIMIA KULTURORE ROME NË BOTËN BASHKËKOHORE DHE PROMOVIMI I SAJ

Kjo tematikë synon t'i ndihmojë nxënësit të kuptojnë se trashëgimia kulturore rome nuk i përket vetëm së kaluarës, por vazhdon të jetë pjesë aktive e jetës kulturore bashkëkohore. Ajo trajton mënyrat se si kultura rome ruhet, promovohet dhe pasurohet sot përmes institucioneve, artistëve, teknologjisë, mediave, arsimit dhe aktiviteteve kulturore.

1) Trashëgimia që jeton edhe sot

Mësuesi prezanton shembuj konkretë të elementeve të kulturës rome që vazhdojnë të jenë pjesë e jetës bashkëkohore, si muzika, vallëzimi, festivale kulturore, letërsia, filmat, veprimtaritë artistike dhe përdorimi i gjuhës rome.

Nxënësit punojnë në grupe dhe plotësojnë tabelën:

Element i trashëgimisë	Si ruhet sot?	Kush kontribuon në ruajtjen e tij?

Në fund diskutohet pse disa elemente ruhen më lehtë se të tjerat.

2) 8 Prilli - Dita Ndërkombëtare e Romëve

Mësuesi prezanton historinë dhe rëndësinë e Ditës Ndërkombëtare të Romëve, e cila festohet më 8 Prill çdo vit.

Nxënësit njihen me:

- Kongresin e Parë Botëror të Romëve (1971);
- flamurin rom;
- himnin rom “Gelem, Gelem”;
- rëndësinë e kësaj dite për promovimin e identitetit dhe kulturës rome.

Në grupe, nxënësit krijojnë një material informues për shkollën me titull: “*Pse festohet 8 Prilli?*”

3) Personalitete rome që ndryshuan botën

Mësuesi prezanton personalitete rome të njohura si p.sh.:

- Django Reinhardt;
- Esma Rexhepova;
- Papusza;
- Ian Hancock;
- Kujtim Paçaku;
- Etj.

Çdo grup studion një figurë dhe përgatit një kartelë biografike ku përfshin:

- jetën;
- veprimtarinë;
- kontributin;
- ndikimin në promovimin e kulturës rome.

Në fund organizohet një "Galeri e personaliteteve rome".

4) Kultura rome në media

Mësuesi paraqet artikuj, video, reportazhe ose faqe interneti që promovojnë kulturën rome.

Nxënësit analizojnë:

- Çfarë informacioni jepet?
- Si paraqitet kultura rome?
- Cilat elemente promovohen më shumë?
- Si mund të ndikojnë mediat në njohjen e kulturave të ndryshme?

Në fund diskutohet roli i medias në ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

5) Trashëgimia kulturore në epokën digjitale

Mësuesi prezanton shembuj të muzeve virtuale, arkivave digjitale, bibliotekave online dhe platformave që dokumentojnë kulturën rome.

Nxënësit eksplorojnë materiale të ndryshme dhe identifikojnë se:

- çfarë lloj informacioni ruhet;
- si ndihmon teknologjia në ruajtjen e kulturës;
- cilat janë avantazhet e dokumentimit digjital.

Në fund hartojnë një listë me mënyra se si teknologjia mund të ndihmojë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

6) *Stereotipe apo realitet?*

Mësuesi prezanton situata ose pohime që lidhen me perceptimet për komunitetin rom.

Nxënësit analizojnë secilin rast dhe diskutojnë:

- A bazohet në fakte?
- A përmban stereotipe?
- Si ndikojnë paragjykimet në jetën e komuniteteve?
- Si mund të luftohen ato përmes edukimit dhe njohjes së kulturës?

Në fund krijojnë një listë me mesazhe që promovojnë respektin dhe mirëkuptimin ndërkulturor.

7) *Ambasadorët e kulturës rome*

Nxënësit imagjinojnë se janë ambasadorë kulturorë që duhet t'ua prezantojnë kulturën rome nxënësve të një shkolle tjetër.

Në grupe, ata përzgjedhin:

- elementin më interesant të historisë;
- një aspekt të gjuhës;
- një traditë;
- një element folklorik;
- një artist ose personalitet;
- një element të trashëgimisë bashkëkohore.

Më pas përgatisin një prezantim të shkurtër dhe argumentojnë pse këto elemente duhen njohur nga të gjithë.

8) *Si ta promovojmë trashëgiminë kulturore rome?*

Si veprimtari përmbyllëse e tematikës, nxënësit punojnë në grupe dhe hartojnë ide konkrete për promovimin e kulturës rome në shkollë dhe në komunitet.

Ata propozojnë:

- aktivitete kulturore;
- projekte digjitale;
- fushata informuese;
- publikime;
- aktivitete artistike.

Në fund secili grup prezanton planin e tij dhe diskuton se cilat ide mund të realizohen realisht.

Kjo veprimtari shërben si urë lidhëse me *produktin final të modulit*, pasi i ndihmon nxënësit të kuptojnë se trashëgimia kulturore nuk mjafton vetëm të njihet, por duhet edhe të ruhet, të promovohet dhe t'u transmetohet brezave të ardhshëm.

9) Veprimtari: "Galeria e personaliteteve rome"

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup studion një personalitet rom. Ata përgatisin një poster, infografik ose prezantim digjital ku përfshijnë:

- të dhëna biografike;
- fushën e veprimtarisë;
- arritjet kryesore;
- ndikimin në promovimin e kulturës rome.

Në fund organizohet një *"Galeri e personaliteteve rome",* ku nxënësit prezantojnë figurat e përzgjedhura dhe diskutojnë se si individët mund të kontribuojnë në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të komunitetit të tyre.

PRODUKTI FINAL

Gjatë zhvillimit të modulit, nxënësit angazhohen në një sërë veprimtarish kërkimore, krijuese dhe bashkëpunuese që lidhen me historinë, gjuhën, traditat, folklorin, muzikën, artet, zejet dhe trashëgiminë kulturore rome. Çdo tematikë kontribuon gradualisht në ndërtimin e produktit përfundimtar, i cili synon të pasqyrojë në mënyrë të integruar njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e zhvilluara gjatë modulit.

Produkti final mund të realizohet në një nga format e mëposhtme:

1) Enciklopedia digjitale e trashëgimisë kulturore rome

Në përfundim të modulit, nxënësit krijojnë një enciklopedi digjitale që prezanton në mënyrë të organizuar dhe të ilustruar elementet kryesore të trashëgimisë kulturore rome. Enciklopedia mund të realizohet në formën e një libri digjital interaktiv ose reviste digjitale.

Gjatë zhvillimit të modulit, çdo tematikë shndërrohet në një kapitull të enciklopedisë. Nxënësit mbledhin informacion, përzgjedhin fotografi, krijojnë ilustrime, hartojnë tekste informuese, përgatisin intervista dhe materiale audio ose video që pasurojnë përmbajtjen.

Enciklopedia përfshin:

- historinë e romëve;
- gjuhën rome;
- traditat dhe zakonet;
- folklorin rom;

- muzikën, vallëzimin dhe artet;
- zejet dhe veshjet tradicionale;
- trashëgiminë kulturore rome në ditët e sotme.

Në fund, enciklopedia publikohet në faqen e internetit të shkollës ose shpërndahet në formë digjitale për nxënësit, prindërit dhe komunitetin.

2) Udhëtim virtual në trashëgiminë kulturore rome

Nxënësit krijojnë një ekspozitë virtuale ndërvepruese ku vizitori "udhëton" nëpër seksione të ndryshme të kulturës rome. Produkti mund të realizohet me prezantime ndwrvepruese, platforma virtuale ose aplikacione të thjeshta digjitale.

Vizitori kalon nga një seksion në tjetrin:

- Historia e romëve;
- Gjuha rome;
- Traditat dhe zakonet;
- Folklori rom;
- Muzika dhe vallëzimi;
- Zejet dhe veshjet tradicionale;
- Trashëgimia kulturore rome sot.

Çdo seksion përmban tekste, fotografi, video, materiale audio, intervista, galeri ilustrimesh dhe elemente ndërvepruese që i japin vizitorit mundësinë të eksplorojë kulturën rome në mënyrë aktive.

Në ditën e prezantimit, nxënësit udhëheqin vizitorët nëpër udhëtimin virtual dhe prezantojnë përmbajtjen e secilit seksion.

3) Arkivi digjital i trashëgimisë kulturore rome

Nxënësit krijojnë një arkiv digjital që dokumenton dhe ruan elemente të ndryshme të trashëgimisë kulturore rome. Arkivi ndërtohet gradualisht gjatë gjithë modulit dhe organizohet në kategori tematike.

Arkivi mund të përmbajë:

- dokumente dhe materiale informuese;
- intervista me anëtarë të komunitetit rom;
- fotografi historike dhe bashkëkohore;
- regjistrime audio dhe video;
- këngë dhe materiale folklorike;

- fjalor me fjalë dhe shprehje në gjuhën rome;
- materiale mbi zejet, veshjet dhe traditat.

Në përfundim të modulit, arkivi prezantohet para komunitetit shkollor si një burim informacioni dhe dokumentimi për kulturën rome, i cili mund të pasurohet dhe të përdoret edhe në vitet e ardhshme nga nxënës dhe mësues të tjerë.

Produkti final shërben si dëshmi konkrete e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të zhvilluara gjatë modulit, si dhe e aftësisë së nxënësve për të hulumtuar, dokumentuar, interpretuar dhe promovuar trashëgiminë kulturore rome si pjesë të trashëgimisë kulturore të Shqipërisë dhe të Evropës.

9. SHPËRNDARJA SUGJERUESE E ORËVE SIPAS TEMATIKAVE

Ndarja e orëve sipas tematikave është sugjeruese dhe mund të përshtatet nga mësuesi në varësi të nevojave të klasës dhe ritmit të të nxënit. E rëndësishme është që të respektohet totali i përgjithshëm prej 35 orësh për zhvillimin e modulit.

Nr.	Tematikat	Orë
1	Historia e romëve	5 orë
2	Gjuha rome	4 orë
3	Traditat, zakonet dhe mënyra e jetesës	5 orë
4	Krijimtaria folklorike rome	4 orë
5	Muzika, vallëzimi dhe artet e tjera rome	4 orë
6	Zejet dhe veshjet tradicionale rome	4 orë
7	Trashëgimia kulturore rome në botën bashkëkohore dhe promovimi i saj	3 orë
8	Realizimi dhe prezantimi i produktit final	6 orë
TOTALI		**35 orë**

Kjo shpërndarje siguron trajtim të balancuar të të gjitha tematikave, duke rezervuar gjithashtu kohë të mjaftueshme për planifikimin, realizimin dhe prezantimin e produktit final, i cili përfaqëson përmbylljen dhe kurorëzimin e punës së zhvilluar gjatë gjithë modulit.

10. BIBLIOGRAFIA

- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Qendra e Botimeve Zyrtare.
- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 96/2017 "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë". Qendra e Botimeve Zyrtare.
- Këshilli i Ministrave. Vendim nr. 621, datë 22.10.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj".
- Ministria e Arsimit dhe Sportit. Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj.
- Ministria e Arsimit dhe Sportit / ASCAP. Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar
- në Republikën e Shqipërisë.
- Ministria e Arsimit dhe Sportit / ASCAP. Programet lëndore të arsimit të mesëm të lartë, sipas kurrikulës së përditësuar.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2021–2025.
- Këshilli i Evropës. Roma History Factsheets. Materiale edukative për historinë, migrimet, kulturën dhe përvojat historike të romëve në Evropë.
- Këshilli i Evropës. Roma History / Holocaust. Materiale edukative për përndjekjen dhe gjenocidin ndaj romëve gjatë Luftës së Dytë Botërore.
- European Commission. EU Roma Strategic Framework for Equality, Inclusion and Participation 2020–2030.
- UNESCO. Language Vitality and Endangerment. Dokument orientues për rëndësinë e ruajtjes së gjuhëve dhe diversitetit gjuhësor.
- ASCAP. Moduli "Historia dhe kultura rome në procesin mësimor". Material trajnimi për mësuesit e arsimit parauniversitar.